



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA PËR BUJQËSI
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Adresa: Dëshmorët e Kombit

DATA/DATUM/DATE	24.01.2025
11 NR/BR.	Zyrtare
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim



Thirrje për aplikim

Drejtoria për Bujqësi e Komunës së Ferizajt në bazë të vendimit nr.11/03 të datës 23.01.2025 në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2025 shpallë Thirrjen për aplikim për projektin : Furnizimi i fermerëve kultivues të pemëve apo perimeve me gypa dhe paisje përcjellëse për ujitje nga lumi apo ndonjë burim tjetër.

Në këtë subvencionim përfshihet furnizimi i fermerëve me gypa të plastikës fi 75 dhe paisje përcjellëse për bartjen e ujit nga burimi deri te parcela apo rezervari i ujit.

Përfitues do të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt,
- Pronën ta ketë në komunën e Ferizajt,
- Të jenë fermerë komercial të perimeve apo pemëve,
- Të jenë fermerë që kultivojnë sipërfaqe me perime së paku 0.10 ha apo që kultivojnë pemë me sipërfaqe minimumi 0.30ha një parcelë e pandarë,
- Ta kenë mundësinë e furnizimit me ujë nga ndonjë burim i ujit(lumi, pusit etj.),
- Toka të jetë në pronësi të fermerit ose e marrë me qera së paku për 5 vite.

Përparësi kanë :

- Fermerët që kanë aplikuar për subvencione- pagesa direkte në MBPZHR për vitin 2024,
- Fermerët që kanë dëshmi për qarkullimin, shitjen e produkteve të tyre.

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve- kati përdhësë- Komuna Ferizaj.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit,
- Fletëaplikacionin e plotësuar (mirret në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve),
- Dëshminë kadastrale për pronësi (fletën poseduese)origjinal,
- Dëshmitë për shitjen e produkteve nga ferma e juaj nëse keni.

Afati për aplikim fillon nga data 24.01.2025 deri më 05.02.2025.